

Gjykata Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik, Divizioni per Kundervajtje ,dhe ate gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me procesmbajtesen Indira Beqa , punetore e kesaj gjykate ,në lenden kundërvajtëse kundër të pandehurit Ali Krasniqi nga fsh.Kaçanik I Vjeter ,komuna e Kaçanikut , për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1.nenpar.1.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare ,e ne baze në baze të nenit 31,73,74, dhe 199 të Ligjit për Kundërvajtje me dt. 28.10.2013 merr këtë;

A K T V E N D I M

I pandehuri Ali Shukri Krasniqi ,I lindur me dt.05.08.1965 ne fsh. Kaçanik I Vjeter,komuna e Kaçanikut ,ku edhe e ka vendbanimin , shqiptar shtetas I Republikes se Kosoves,I martuar prind I dy femijeve ,k ate kryer fakultetin , punëtor në "Sharr Cem " ne Han te Elezit ndersa jeton ne gjendje së mesme ekonomike,

Ë sht ë për gje gj ë s

Sepse si zyrtar I larte public ne poziten e keshilltarit komunal ne Asamblene Komunale ne Kaçanik ,nuk e ka bere deklarimin e rregullt vjetor te pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit deri me daten 31.03.2012.

Me qka ka kryer kundervajtje nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.1.1 Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare

Andaj në bazë të nenit 31,73,74 dhe 199 te Ligjit per Kundervajtje dhe nenit 17 par 1 nenpar.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare,

D E N O H E T

Me denim me gjobe në shumë prej 300 € (treqind euro) ,te cilin eshte e obliguar qe ta paguaj në afat prej 15(pesëmbëdhjete) ditësh nga dita e plotfuqishmërise të këtij aktvendimi,në të kundërtën ,konform nenit 5 al.1 të Ligjit per kundërvajtje,dënimi me gjobë do t'I zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burgu do t'I llogariten nga 15 (Njëzet) €

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaje pranë kësaj gjykate shumë prej prej 5.00 € ne emer te paushallit gjyqesor në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërise së këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Op.	Er. Prot.
Dep.	Prot. No.
Nr. i tag.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages	Date
DPK/DMP	03-3766/13
03	07-11-2013

A r s y e t i m

Agjensia Kunder Korrupsionit ne Prishtine , ka parshtruar kërkesen per fillimin e procedures kundervajtese nr.01-2322/12 te dates 02.07.2012 , kunder te pandehurit Ali Krasniqi nga fsh.Kaçanik I Vjeter,komuna e Kaçanikut ,per kundervajtje nga neni 5 ,6 dhe 9 i sanskionuar me nenin 17 par 1 nenpar.3 të Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare,

Ne baze te kerkeses se parshtruar gjyqtarja filloi proceduren kundervajtese me marrjen ne pyetje te pandehurin I cili ne fjalen e pranoi pergjegjesine per kundervajtjen ,duke shtuar se ka qene hera e pare kur ne vitin 2012 ndaj te tij eshte kerkuar qe t'a deklaroje pasurine prane AKK,se ne Prishtine,andaj edhe ka kerkuar nga gjykata qe me rastin e marrjes se vendimit t'I shqiptohet nje denim sa me I ulet qe te jete e mundur .

Per t'u deklaruar rreth kualifikimit juridik te kundervajtjes ,gjyqtarja ftoi edhe perfaqesuesin e AKK,se ,ku me ate rast perfaqesuesi me autorizim I AKK,se Enis Sadiku deklaroi se, mbetet ne teresi prane kualifikimit juridik te kundervajtjes ,pasi qe sipas tij I pandehuri asnjehere me pare nuk e ka deklaruar pasurine e tij prane AKK,se ,gjersa ka qene ne poziten e keshilltarit komunal ,pasi qe kuptohet se edhe ligjerisht nuk ka patur obligim,e qe per kete arsye sipas tij nuk mund te konsiderohet se kemi te bejme me deklarimin e rregullt vjetor por me deklarimin sipas kerkeses se Agjensise .

Në bazë të dhënave si në kërkesë , deklarates së të pandehurit ,deklarates se perfaqesuesit me autorizim te AKK,se ne Prishtine dhe shkresave tjera te lendes , gjyqtarja konstatoi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës kundërvajtëse nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par.1 nenpar.1.1 pasi qe me Ligjin nr.04/L-050 te gjithë keshilltaret komunale te Asambleve komunale jane perfshire ne listen e zyrtareve te larte qe njeherit edhe kane obligim deklarimin e rregullt vjetor prane AKK,se ne Prishtine,dhe per mandatin sa jane ne kete pozite kane per obligim deklarimin e rregullt vjetor te pasurise se tyre, dhe rrjedhimisht obligimi I deklarimit te pasurise del sipas ligjit, edhe nese agjensioni nuk kerkon deklarimin e pasurise.

Andaj gjykata duke u bazuar ne te theksuarat me larte ka bere rikualifikimin juridik te kundervajtjes dhe te pandehurin conform nenit 17 par.1 nenpar.1 e shpalli përgjegjës dhe e dënoi me denim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) , te cilin eshte I obliguar qe ta paguaje ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmerise se ketij aktvendimi ne te kunderten conform nenit 5 te LK,se dënimi me gjobë do t'I zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burg do t'I llogariten nga 15 (pesembedhete) € .

Gjykata me aplikimin e nenit 9 par.1 pika 1 te pandehurit I ka shqiptuar denim me gjobe nen masen minimale te denimit te percaktuar per kete kundervajtje,pasi qe I pandehuri I ka evituar pasojat e kesaj vepre kundervajtjese duke e deklaruar pasurine e tij prane AKK,se me date 22.08.2012.

